



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 97, Datë 15.04.2020

PËR DHËNIE LEJE TË PAPAGUAR

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 24/4 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenet 160, 161 e 189, pika 1, gërma “a” të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë pasi u njoh me relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale:

V E N D O S I:

1. Të japë leje të papaguar për arsye familjare për Z.Elion Mustafaj, prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për periudhën 1 vjeçare duke filluar nga data 01.05.2020 deri në datë 30.04.2021.
2. Me këtë vendim të njihet prokurori Elion Mustafaj, Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GËNT IBRAHIMI

ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SËITI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

